



# Deklarata IPsyNet për LGBTIQ + Shqetësimet



- » Ne e pranojmë, si përkrahës të parimit që të drejtat e njeriut janë universale, se të gjitha qeniet njerëzore janë të denja për dinjitet dhe respekt, duke përfshirë respektimin e diversitetit të bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe shprehjen gjinore, ose në dallimet në zhvillimin seksual. Ne besojmë se, diskriminimi dhe keqtrajtimi psikologjik, nuk janë në përputhje me aspiratat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (Deklarata Universale e Parimeve Etike për Psikologët, 2008). Ne mbështesim në mënyrë aktive zhvillimin dhe mbështetjen për trajtimin afirmues dhe gjithëpërfshirës të LGBTIQ +, si dhe ofrimin e shërbimeve.
- » Ne pajtohemi që psikologjia si shkencë dhe profesion ka ekspertizë të bazuar në dekada kërkimesh që tregojnë se identitetet dhe shprehitë LGBTIQ + janë ndryshime normale dhe të shëndetshme të funksionimit dhe marrëdhënieve njerëzore. Për shembull, siç përcaktohet në ICD-10 (Organizata Botërore e Shëndetit, 1990, f. 11), homoseksualiteti nuk është një çrregullim mendor i diagnostikueshëm. Ne sfidojmë në mënyrë aktive pretendimet e bëra nga grupe politike, shkencore, fetare apo grupe të tjera që pretendojnë ose pohojnë se identitetet, shprehitë dhe karakteristikat e LGBTIQ + janë anormale ose jo të shëndetshme.
- » Meqenëse identitetet dhe orientimet LGBTIQ + janë ndryshime normative të përvojës njerëzore dhe nuk janë çrregullime mendore të diagnostikueshme, ato nuk kërkojnë ndërhyrje terapeutike për t'i ndryshuar. Duke patur parasysh që terapitë e konvertimit stigmatizojnë në mënyrë aktive orientimet e të njëjtit seks dhe identitetet transgjinore, përveçse kanë potencial për të dëmtuar, ne mbështesim qasjet afirmuese të terapisë për personat LGBTIQ + dhe refuzojmë terapitë që synojnë t'i shkaktojnë dëm komunitetit LGBTIQ+.
- » Individët transgjinorë dhe jokonformues gjinorë kanë të drejtë të jetojnë sipas identitetit të tyre gjinor dhe të kenë akses në ndihmë mjekësore, psikoterapeutike dhe shoqërore sipas nevojës. Kjo mbështetje duhet të ofrohet pavarësisht nëse personi ka një identitet gjinor binar ose jo binar madje dhe nëse kërkon akses në ndryshimet shoqërore apo mjekësore ose në një, disa, apo të gjitha trajtimet e mundshme. Për më tepër, ne mbështesim autonominë e plotë të individëve transgjinorë dhe jokonformues gjinorë në afirmimin e identitetit të tyre gjinor. Mbështetja e duhur psikologjike mund të jetë e dobishme për zhvillimin e identitetit dhe vendimmarrjen e tyre, në lidhje me ndryshimet e tyre shoqërore dhe mjekësore (Coleman et al., 2012). Ne kundërshtojmë me forcë rregulloret që, i detyrojnë individët transgjinorë dhe jokonformues gjinorë, ti nënshtrohen sterilizimit, divorcit, ose procedurave të tjera që mund të kenë efekte të dëmshme stigmatizuese ose mendore, fizike ose shoqërore, me qëllim që të marrin, në këmbim, mbështetjen e dëshiruar për ndryshim. Ne pohojmë se individët transgjinorë dhe jokonformues gjinorë kanë të drejtë të përcaktojnë identitetin e tyre, si dhe të vendosin të marrin kujdesin shëndetësor afirmues dhe që ka lidhje me ndryshimin e tyre sipas dëshirës (Yogyakarta Principles, 2007).
- » Disa persona LGBTIQ + mund të pësojnë shqetësime psikologjike për shkak të ndikimit të stigmës sociale dhe paragjykimeve ndaj personave LGBTIQ+ në përgjithësi ose ndaj identitetit të tyre individual brenda spektrit LGBTIQ+.
- » Individët LGBTIQ+ me identitete jomonoseksuale (p.sh., biseksuale, panseksuale) dhe jo-cis (p.sh., trans, jo-binarë, agjinorë), si dhe individët LGBTIQ + me identitete të kryqëzuara pakicash (p.sh., bazuar në racën, përkatësinë etnike, aftësinë e kufizuar, fenë, gjininë, klasën shoqërore), mund të jenë veçanërisht të rrezikuar nga stresi minoritar, diskriminimi, brenda dhe jashtë popullsisë LGBTIQ +, dhe nga vështirësitë psikologjike që rrjedhin prej tyre. Ne e dënojmë diskriminimin që marrin për bazë identitetet e kryqëzuara të pakicave brenda dhe jashtë popullatës LGBTIQ +. Për më tepër, ne mbështesim aktivisht hulumtimin psikologjik dhe praktikën që marrin plotësisht në konsideratë kryqëzimin e identiteteve të personave LGBTIQ + me identitetet e të tjerëve, siç janë etnia, klasa shoqërore dhe feja.
- » Përpjekjet për të trajtuar si të sëmurë orientimet, identitetet ose personat LGBTIQ+, duke i lidhur ato me shëndetin jo të mirë mendor, keqinterpretojnë efektet e stigmatizimit dhe armiqësisë ndaj mjedisit, si të natyrshme për orientimet seksuale LGBTIQ+, identitetet dhe shprehitë gjinore, ose ndryshimet biologjike. Ne mbrojmë heqjen e stigmës së psiko-patologjisë nga identitetet dhe shprehitë LGBTIQ+ dhe kundërshtojmë keqpërdorimin e hulumtimeve mbi pabarazitë shëndetësore, me të cilat përballen individët LGBTIQ +, të cilat kërkojnë të keqinformojnë publikun dhe të bëjnë përpjekje për të trajtuar si të sëmurë personat LGBTIQ +.
- » Mungesa e informacionit dhe keqinformimi i psikologëve për personat dhe identitetet LGBTIQ+ mund të përjetësojnë diskriminimin, stereotipizimin dhe mundësinë e abuzimit me shëndetin fizik dhe mendor. Ne mbrojmë përfshirjen e personave LGBTIQ+ si ekspertë dhe si partnerë aktivë e të barabartë në kërkime dhe zhvillim të politikave për hulumtime dhe nisma të politikave që i shqetësojnë ata. Ne mbështesim zhvillimin e hulumtimit psikologjik dhe edukimin që nuk është normativë hetero- ose cis- (p.sh., Clarke, Ellis, Peel, & Riggs, 2010). Për më tepër, ne ofrojmë njohuri psikologjike për rrjetet psikologjike, organizatat, politikëbërësit, median dhe publikun. Së fundi, në bazë të njohurive të bazuara shkencërisht, ne jemi për një ndërgjegjësim më të madh për nevojat e shëndetit dhe mirëqenies së personave LGBTIQ+ për të përmirësuar politikën publike dhe komunitetet LGBTIQ +.

## MIRATIMET ORGANIZATIVE

### NDËRKOMBËTARE

Association for Contextual Behavioral Science

### RAJONAL

European Federation of Psychologists Associations

Interamerican Society of Psychology/  
Sociedad Interamericana de Psicología

### KOMBËTAR

#### AFRIKA E JUGUT

Psychological Society of South Africa

#### AUSTRALIA

Australian Psychological Society

#### BANGLADESHI

Bangladesh Psychological Association

#### BRAZIL

Brazilian Association of Teaching of Psychology/  
Associação Brasileira de Ensino de Psicologia

Brazilian Association of Legal Psychology/  
Associação Brasileira de Psicologia Jurídica

Brazilian Association of Psychotherapy/  
Associação Brasileira de Psicoterapia

Brazilian Association of School and Educational Psychology/  
Associação Brasileira de Psicologia Escolar e Educacional

Brazilian Institute of Psychological Evaluation/  
Instituto Brasileiro de Avaliação Psicológica

Federal Council of Psychology/  
Conselho Federal de Psicologia

National Association for Research and Graduate Studies in Psychology/  
Associação Nacional de Pesquisa e Pós-graduação em Psicologia

National Coordination of Psychology Students/  
Coordenação Nacional de Estudantes de Psicologia

#### ÇEKINË

The Czech-Moravian Psychological Society/  
Českomoravská Psychologická Společnost

#### FILIPINET

National Association for Sikolohiyang Pilipino/  
Pambansang Samahan sa Sikolohiyang Pilipino

Psychological Association of the Philippines

#### GJERMANIA

Association for Lesbians, Gay, Bisexual, Trans\*,  
Intersexual and Queer People in Psychology/  
Verband für lesbische, schwule, bisexuelle, trans\*,  
intersexuelle und queere Menschen in der Psychologie  
(VLSP\*)

German Psychological Society/  
Deutsche Gesellschaft für Psychologie

#### GUATEMALË

Guatemalan Psychological Association/  
Asociación Guatemalteca de Psicología

#### HOLLANDA

Dutch Association of Psychologists /  
Nederlands Instituut van Psychologen

#### HONG KONG

Hong Kong Psychological Society

#### HUNGARIA

Hungarian Psychological Association,  
LMBTQ Section/  
Magyar Pszichológiai Társasági

#### KAMERONI

Cameroon Chamber of Actors in Psychology/  
Chambre Camerounaise des Acteurs en Psychologie

#### KANADA

Canadian Psychological Association/  
Société Canadienne de Psychologie

#### KILI

Psychologists Association of Chile/  
Colegio de Psicólogos de Chile

#### KOLUMBIA

Colombian College of Psychologists/  
Colegio Colombiano de Psicólogos

#### LIBAN

Lebanese Psychological Association

#### MBRETËRIA E BASHKUAR

British Psychological Society

#### NORVEGJIA

Norwegian Psychological Association/  
Norsk Psykologforening

#### POLONIA

Association for Contextual Behavior Science Polska

Polish Psychologists' Association/  
Stowarzyszenie Psychologów Polskich

Polish Dialectic Behavioral Therapy Association/  
Polskie Towarzystwo Terapii Dialektyczno-Behawioralnej

Polish Association for Cognitive and Behavioral Therapy/  
Polskie Towarzystwo Terapii Poznawczej i Behawioralnej

#### PORTUGALIA

Order of Portuguese Psychologists/  
Ordem dos Psicólogos Portugueses

#### PORTO RIKO

Puerto Rico Psychological Association/  
Asociación de Psicología de Puerto Rico

#### RUSIA

Russian Psychological Society/  
Российское психологическое общество

#### SHQIPERIA

Order of Psychologists of Albania

#### SHTETET E BASHKUARA

Association for Behavioral and Cognitive Therapies

American Psychological Association

National Latinx Psychological Association

#### SPANJA

Spanish Psychological Association/  
Colegios Oficiales de Psicólogos

#### TAJVANI

Taiwan Counseling Psychology Association

Taiwan Counseling Psychologist Union

Taiwan Guidance and Counseling Association

#### URUGUAI

Coordinator of Psychologists of Uruguay/  
Coordinadora de Psicólogos del Uruguay

#### ZELANDA E RE

New Zealand Psychological Society

## REFERIME

- Clarke, V., Ellis, S. J., Peel, E., & Riggs, D. W. (2010). *Lesbian, gay, bisexual, trans and queer psychology: An introduction*. Cambridge, UK: Cambridge University Press. <https://doi.org/10.1017/9781108303750>
- Coleman, E., Bockting, W., Botzer, M., Cohen-Kettenis, P., DeCuypere, G., Feldman, J., . . . Zucker, K. (2012). Standards of care for the health of transsexual, transgender, and gender nonconforming people, Version 7. *International Journal of Transgenderism*, 13, 165-232. doi:10.1080/15532739.2011.700873
- Universal Declaration of Ethical Principles for Psychologists. (2008). Available from the International Union of Psychological Science Website: <https://www.iupsys.net/about/declarations/universal-declaration-of-ethical-principles-for-psychologists/>
- World Health Organization. (1990). International statistical classification of diseases and related health problems (11th ed.). <https://www.who.int/standards/classifications/classification-of-diseases>
- Yogyakarta principles: The principles on the application of international human rights law in relation to sexual orientation and gender identity. (2007). <http://yogyakartaprinciples.org/principles-en/yp10/>